



Pranuar / Dorezuar Prilijeno / Prudato Received / Delivery	03-06-2021	1	viti god year
Organ / Njësia Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SJK	2847/2021		113



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.290/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Zyle Millaku Gojnovci, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën e datës 21.04.2021 me numër A.nr.290/2021, të parashtruar nga ankuesja [] përmes përfaqësuesit të autorizuar Avokatit Argjend Xheladini me adresë: rruga "Adem Jashari", pa numër Komuna e Vitisë, kundër organit të punësimit, Komunës së Vitisë, në çështjen administrative-juridike "Kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur më datë 03.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur në lidhje me ankesën me numër A.nr.290/2021 e datës 21.04.2021 të parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja [] me datë 21.04.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1914/2021 të regjistruar me numër A.nr.290/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të Komunës së Vitisë lidhur me kërkesën e datës 21.04.2021, për mos pagesë të një page mujore, me rastin e vdekjes së bashkëshortit të saj, z. [] cili ka qenë i punësuar në Komunë të Vitisë, në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 26.04.2021 ka dërguar kërkesë tek Komuna e Vitisë, për përgjigje në ankesë të ankuseses, më datë 26.05.2021 Komuna e Vitisë është përgjigje në kërkesë sipas shkresës zyrtare me numër protokolli 2013/2021 dërguar përmes E-mailit të datës 26.05.2021, sipas kërkesës së përsëritur me E-mailin e datës 25.05.2021, të bashkangjitura, 1/1 faqe.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.290/2021 të datës 21.04.2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim civil të Kosovës; Kërkesë

e datës 14.01.2021 nr. protokoli 06-320/04-19998 drejtuar Drejtorisë për Buxhet dhe Financa; Ankesë e datës 21.04.2021 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Vitisë; Kërkesë për Komunën e Vitisë për përgjigje ne ankese per shkak të mos përgjigjes së datës 26.04.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstatohet se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesja* *sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankuesja në cilësi të bashkëshortes së të ndjerit i cili ka qenë i punësuar në Komunë të Vitisë, në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, me datë 21.04.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të Komunës së Vitisë, lidhur me kërkesën e datës 14.01.2021, për mos pagesë të një page mujore, me rastin e vdekjes së bashkëshortit të saj, e cila pretendon që ti bëhet pagesa e një pagë mujore, në kuptim të nenit 22 paragrafi 2 nën paragrafin 2.4 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, dhe nenit 22 paragrafi 1 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil.

Bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent për të vendosur vetëm për nëpunësit civil dhe kandidatet për pranim në Shërbimin civil, siç është përcaktuar në nenin 2 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se ankesa e ankueses është e pa lejuar dhe në kundërshtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku është e përcaktuar se: "1. Për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli ka këto funksione themelore: "1.1. shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil", që në rastin konkret ankuesja nuk ka status të nëpunëses civile dhe kandidate për pranim në shërbimin civil, dhe se Këshilli në bazë të funksioneve të saj ka kompetencë të shqyrtojë ankesat e nëpunësve civil të punësuar në shërbimin civil të Kosovës dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil.

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se ankesa e ankueses është e pa lejuar, duke u bazuar në nenin 16 paragrafi 1, 2 të Ligjit Nr. 06/L -048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku është përcaktuar se: "1. Nëpunësi civil, apo kandidati për pranim në shërbimin civil i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtrorë ankesë në Këshill, lidhur me pretendimin për shkeljen e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës. 2. Nëpunësi civil apo kandidati për pranim në shërbimin civil ka të drejtë që të parashtrorë ankesë në Këshill në mënyrë elektronike në pajtim me legjislacionin përkatës për komunikimin elektronik si dhe rregullat e përcaktuara me rregulloren përkatëse për parashtrimin e ankesave në Këshill, sepse Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se nuk ka kompetencë për të shqyrtuar ankesën e ankueses bashkëshorte e të ndjerit z. i cili ka qenë i punësuar në Komunë të Vitisë, në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr'.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për praninë në Shërbimin Civil, po ashtu ka marrë për bazë përgjigjen e datës 26.05.2021 të organit të punësimit gjegjësisht Njesisë së Personelit të Komunës së Vitisë, që ankuesja nuk është e punësuar në administratën e Komunës, dhe mbi këtë bazë është konstatuar se ankuesja nuk ka status të nëpunës civil.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi.

Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.290/2021, datë 03.06.2021.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Arben MEHEMI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar Avokatit
- Kryetarit të Komunës së Vitisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunës së Vitisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

